



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:076624
Datë: 23.04.2024
Numri i dokumentit: 05630439

Ac.nr.2572/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi, dhe Enes Mehmeti, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses S.B., nga Gjakova, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson F.S., avokat në Gjilan, kundër të paditurës Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, rruga “Dëshmorët e Lirisë”, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson V.R., me objekt kontesti pagesa e shpërblimit jubilar, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.518/21, të datës 08.02.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.518/21, i datës 08.02.2022, në pikën I të dispozitivit, **VËRTETOHET**.

II. Mbetet e pashqyrtuar pika II e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e atakuar, C.nr.518/21, të datës 08.02.2022, ka vendosur si në vijim: “I. **APROVOHET** pjesërisht kërkesëpadia e paditëses S.B. nga Gjakova dhe **DETYROHET** i padituri Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, që paditëses në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite të përvojës së punës, t’ia paguaj shumën prej 754,00 (shtatëqind e pesëdhjetë e katër euro), me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 20.04.2021, e gjerë në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 269,20 euro (dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë

euro e njëzet cent), të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përbarimit me detyrim.

II. REFUZOHET e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses mbi shumën e gjykuar në pikën I të këtij aktgjykimi, dhe atë në shumën prej 274,66 (dyqind e shtatëdhjetë e katër euro e gjashtëdhjetë e gjashtë cent)”.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ankesën ta aprovojë si të bazuar, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore të hedhet poshtë.

Paditësja përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur përgjigje në ankesë me propozim që ankesa e të paditurës të refuzohet, ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohen si i bazuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 20.04.2021, në gjykatën e shkallës së parë, ka parashtruar padi kundër të paditurës, për pagesën e shpërblimit jubilar. Në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ka theksuar se e njëjta është në marrëdhënie pune tek i paditura në punët dhe detyrat e punës: Infermiere në Repartin e Ortopedisë të SP “Isa Grezda” në Gjakovë, ku aktualisht i ka bërë 20 vite përvojë pune tek e paditura. Ka shtuar se paditësja disa herë më kërkesë verbale iu ka drejtuar të paditurës për realizimin e pagesës në raport me shpërblimin jubilar, por deri me tani i njëjti nuk i është përgjigjur. Ka theksuar së kërkesa e paditëses është e parashtruar konform nenit 17 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2, të Kontratës Kolektive Sektoriale, duke i propozuar gjykatës që të aprovojë kërkesëpadinë e paditëses, ashtu qe ta detyroj të paditurën që paditëses t’ia paguaj kompensimin e shpërblimit jubilar në shumë prej 1,028.66 euro, në vlerë të dy pagave mujore të saj me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, si dhe t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore.

E paditura në përgjigje, dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses për shkak se me Ligjin e punës nuk është paraparë kompensimi i shpërblimeve jubilarë, duke u bazuar në nenin 90 pika 5 e ligjit të lartcekur, i cili parasheh se zbatimi i një marrëveshjeje kolektive, vlen vetëm për ata punëdhënës dhe punonjës të tyre, të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara më marrëveshjen kolektive. Në rastin konkret shton se Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë – këtu e paditura, nuk është nënshkruar i marrëveshjes në të cilën bazohet padia dhe rrjedhimisht nuk bart përgjegjësi të tilla ndaj palës paditëse, ashtu që i njëjti duhet t’i drejtohet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë në Kosovë. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të pathemeltë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.518/21, të datës 08.02.2022, me të cilën e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se në bazë të kontratën e punës, në kohë të pacaktuar, me nr. të prot. 3261, datë 31.12.2012, është vërtetuar fakti se paditësja ka lidhur kontratë pune me të paditurën Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, detyrat e punës: Infermiere në Repartin e Ortopedisë, duke filluar nga data 01.01.2013, ndërsa nga vërtetimi i marrëdhënies së punës, datë 29.01.2021, i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, është provuar rrethana se paditësja është e punësuar tek e paditura Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, si Infermiere në Repartin e Ortopedisë, prej datës 19.04.2001, e tutje. Nga lista e pagave e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, datës 31.10.2020, e cila i referohet muajit tetor 2020, vërteton rrethanën se paditësja ka 20 vite përvojë pune dhe realizon pagë bazë mujore prej 377 euro. Nga provat e administruara si më lartë, gjykata ka gjetur se paditësja është e punësuar tek e paditura për më shumë se 20 vite, e që prej kohës kur i ka mbushur 20 vite përvojë pune, të njëjtës nuk i është bërë pagesa për shpërblim jubilar në vlerë të dy pagave mujore, të parapara me nenin 17 par. 3 pika 3.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë (KKS). Mos pagesën e këtyre pagave e ka pohuar edhe e paditura përmes përgjigjes në padi, duke pretenduar se nuk është nënshkruar i marrëveshjes në të cilën bazohet padia dhe rrjedhimisht nuk bart përgjegjësi të tilla ndaj palës paditëse.

Gjykata lidhur me bazën e kërkesëpadisë vendosi duke ju referuar Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, të nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, dispozitat e së cilës aplikohen në tërë territorin e Kosovës, ku në nenin 17 paragrafi 3 pika 3.2, është paraparë se: *“Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë [...] Për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, të punëdhënësi i fundit në vlerë të dy pagave mujore të tij”*. Përvojën e punës së paditëses gjykata e vërtetoj nga vërtetimi, i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, datë 29.01.2021, ndërsa lartësinë e pagës mujore prej 377.00 euro, e vërtetoj nga lista e pagave e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, ku ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar, duke ia njohur shumën prej 754,00 euro, me përlllogaritje si në vijim: $(377,00 \times 2 = 754,00 \text{ euro})$.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimi, duke refuzuar pjesërisht kërkesën e paditëses dhe atë në shumë prej 274,66 euro, pasi që ka ardhur në përfundim së paga mujore bazë (pa shtesa) e paditëses është saktësisht 377,00 euro, bazuar në listën e pagave të administruar në shqyrtimin kryesor. Gjykata vlerëson së paga mujore me shtesat tjera të paraqitura në listën e pagave dhe atë pagesa e shujtave, nuk mund të jenë objekt përfitimi nga paditësja, pasi që legjislacioni aktual i punës ka bërë dallimin e pagës dhe shtesave tjera në punë.

Lidhur me kamatën, gjykata ka vendosur në bazë të nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë konform nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Meqenëse e paditura me ankesë, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka goditur vetëm nga shkak i zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, Gjykata e Apelit, në këtë rast është kufizuar në vlerësimin e kësaj baze, si dhe në vlerësimin nëse aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe ka gjetur së aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në këto shkelje.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale, pasi që në bazë të nenit 17 paragrafi 3, nënparagrafi 3.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të datës 11.06.2018, është paraparë së *“Punëtorët shëndetësor në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: Për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy pagave mujore të tij”*. Tutje sipas paragrafit 4 të këtij neni përcaktohet së *“Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë, Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”*. Në rastin konkret nuk ka qenë kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura ku në bazë të vërtetimit për përvojën e punës të datës 29.01.2021, të lëshuar nga e paditura, është vërtetuar fakti së paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura që nga data 19.04.2001, e që rezulton së 20 vite të përvojës së punës i ka arritur me datë 19.04.2021, në kohën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale. Andaj, gjykata e shkallës së parë duke i referuar këtyre dispozitave, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur që paditëses për 20 vite të përvojës së punës t'i njihet kompensimi në vlerë të dy pagave mujore në shumë të përgjithshme prej 754.00 euro, ku paga bazë mujore e paditëses është 377.00 euro.

Sa i përket pretendimit ankimor së e paditura nuk ka legjitimitet real pasiv pasi që me asnjë akt juridik nuk është përcaktuar që përmbushja e detyrimit për pagesën e shpërblimit jubilar të realizohet nga e paditura, dhe si e tillë kërkesëpadia duhet drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë, Gjykata e Apelit gjeti së ky pretendim i të paditurës është i pabazuar, pasi që sipas paragrafit 4 të nenit 17 të KKS-së punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë, e që në këtë rast si punëdhënës është e paditura, ndërsa Kontrata Kolektive Sektoriale është nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë, në cilësinë e autoritetit me të latë mbikëqyrës në sektorin e shëndetësisë, ku sipas nenit 4 të kësaj kontrate është përcaktuar së kjo kontratë gjëne zbatim për të gjithë të punësuarit nëpër institucione shëndetësore, duke përfshirë tri nivelet e sistemit

shëndetësor, atë parësor, dytësor dhe tërësore. Lidhur me pretendimin se e paditura si njësi organizative vartëse e SHSKUK-së nuk posedon xhirollogari të pavarur, dhe në bazë të buxhetit të përcaktuar për vitin 2021, nuk është paraparë vij buxhetore për këtë kategori, dhe në mungesë të linjës buxhetore përkatësisht mjeteve financiare e paditura nuk ka mundësi objektive për ta përmbushur obligimin e kompensimit të pagave jubilarë, Gjykata e Apelit vlerëson së koordinimi në mes të nivelit qendror dhe lokal në drejtim të alokimit të mjeteve për këtë kategori të pagesave që buron nga Kontrata Kolektive është çështje e brendshme e të paditurës me nivelin qendror dhe kjo assesi nuk mund të afekton në të drejtën e paditëses dhe detyrimin e të paditurës.

Vendimi lidhur me kamatën është marrë konform nenit 382 të LMD-së dhe Mendimit juridik për kamatën i Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 02.12.2020. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e nenit 449, 452.1, dhe 453 të LPK-së.

Pika II, e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë nuk është shqyrtuar sepse ankesa nuk ka qenë e drejtuar përkitazi me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.2572/2022, datë 23.04.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Hysni Bardheci